

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË
PËR VITIN 2024

Nr. Rendor¹	Data e kërkesës²	Objekti i kërkesës³	Data e përgjigjes⁴	Përgjigje⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës⁶	Tarifa⁷
1.	03.01.2024	Kërkesë për informacion mbi numrin e çështjeve të organizuara me short manual kur sistemi i çështjeve nuk ka funksionuar në mënyrë të dokumentuar për periudhën nga viti 2018 deri ne datën 22 dhjetor 2023 nga z. A.K	08.01.2024	Për çështjet të organizuara me short manual kur Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), nuk ka funksionuar për vitet 2018 - 22 dhjetor 2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nuk ka patur asnjë rast që çështjet të jenë organizuar me short manual si pasoje e mosfunksionimit të sistemit.	E plotë	Nuk ka

¹Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

²Data e regjistrimit të kërkesës

³Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴Data e kthimit të përgjigjes

⁵Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

⁷Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

2.	09.01.2024	Kërkesë për informacion nga Organizata SCIDEV, në të cilën kërkohet vendosja në dispozicion e informacionit lidhur me numrin e padive gjyqësore me palë gazetarët ose punonjësit e medias për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023 si dhe stadin e shqyrtimit të tyre.	10.01.2024	Nga verifikimi nuk rezulton të jetë depozituar pranë Gjykatës e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023 asnjë kërkesëpadi me palë gazetarë apo punonjës media.	E plotë	Nuk ka
3.	01.02.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit ndaj shtetases A.S nga z. F.Zh	08.02.2024	Vënë në dispozicion vendimi i anonimizuar.	E plotë	Nuk ka
4.	08.02.2024	Kërkesë për informacion sa është numri i çështjeve në të cilat Gjykata e Korçës ka lejuar martesën e një shtetasi të mitur, nën moshën 18 vjeç, në zbatim të nenit 7 të Kodit të Familjes, gjatë viteve 2017-2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Nga znj.M.R	13.02.2024	Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për periudhën 2017-2023 është depozituar vetëm 1 (një) kërkesë me objekt “Lejim lidhje martese” sipas nenit 7 të Kodit të Familjes. Gjykata me vendimin e saj, ka pranuar kërkesën duke lejuar lidhjen e martesës së një shtetase (femër) nën moshën 18 vjeç.	E plotë	Nuk ka

5.	19.02.2024	Kërkesë për informacion mbi numrin e kërkesave të depozituara pranë gjykatës së Korçës me objekt “zgjidhje martese” për vitet 2022-2023. Nga gazetari T.F “Vizion Plus”	19.02.2024	Mbi numrin e kërkesave me objekt “zgjidhje martese” për vitet 2022-2023 ju bëjmë me dije se: Për vitin 2022 janë depozituar 398 kërkesa. Për vitin 2023 janë depozituar 402 kërkesa.	E plotë	Nuk ka
6.	23.02.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit ndaj shtetasit A.P nga znj. A.C	26.02.2024	Vënë në dispozicion vendimi i anonimizuar.	E plotë	Nuk ka
7.	26.02.2024	Kërkesë për informacion Sa vepra penale kryer nga të miturit janë regjistruar përgjatë vitit 2023 dhe vitit 2024, dhe cilat janë këto vepra penale nga gazetarja. S.L “Sot7”	05.03.2024	Gjatë vitit 2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë janë regjistruar gjithsej 5 çështje penale me të mitur dhe janë gjykuar 4 prej tyre, Nisur nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se kriminaliteti për të mitur në Rrethin Gjyqësor Korçë kryesisht karakterizohet nga veprat penale me rrezikshmëri	E plotë	Nuk ka

				të ulët dhe të lartë, ndërsa nuk ka raste të veprave penale me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore. Konkretisht gjate vitit 2023 jane gjykuar 4 çështje penale me të pandehur të mitur. Veprat më të përhapura të gjykuara nga të miturit janë Dhunë në familje, Ndihe për kalim të paligjshëm të kufijve, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, largim nga vendi i aksidentit.		
8.	28.02.2024	Kërkesë për informacion Sa kërkesa për urdhëra mbrojtje janë depozituar ne gjykatë gjate vitit 2023 dhe në dy muajt e pare të vitit 2024. Nga cila zone dhe çfarë grupmoshë janë regjistruar si dhe statusi shoqëror i kërkuësve nga gazetarja K.K “RTSH Korça”	01.03.2024	Vënë në dispozicion statistikat mbi urdhërat e mbrojtjes.	E plotë	Nuk ka

9.	07.03.2024	Kërkesë për informacion mbi veprën penale që akuzohet shtetasi I.Z nga gazetari S.K “Tv Klan”	08.03.2024	Kthim përgjigje ku shtetasi I.Z është i pandehur për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i kodit penal, dhe aktualisht është paraqitur kërkesa nga ana e Prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq.	E plotë	Nuk ka
10.	15.03.2024	Kërkesë për informacion Sa ka qenë numri i çështjeve penale të rregjistruara që lidhen me veprën penale të parashikuar në nenin 290 të Kodit Penal ”Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor” për periudhën 01.01.2023-31.12.2023? Sa prej këtyre çështjeve kanë përfunduar dhe sa janë akoma në proces ? Nëse informacionin e dispononi në formë tabelash apo grafiku (evidenca statistikore) lutemi të na e dërgoni në atë formë, nga znj.I.Sh	20.03.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me veprën penale të parashikuar në nenin 290 të Kodit Penal ”Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor” për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, bashkëlidhur vënë ne dispozicion tabelën në exel me të dhënat statistikore të kërkuara.	E plotë	Nuk ka

11.	22.03.2024	Kërkesë për informacion a ka pasur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë) nga data 09.02.2018 (datë kur ka hyrë në fuqi VKM-ja nr.68, date 07.02.2018) deri më datë 28.02.2021 (data e përfundimit të marrdhënies sime të punës pranë institucionit tuaj), lokal/vend të posaçëm ngrënie për punonjësit? Nëse jo, referuar listpagesave respektive, a është zbatuar VKM-ja e sipërcituar, duke u dhënë shpërblimi për ushqimin në formën e pagës në natyrë, me kufi të përcaktuar sipas kësaj VKM-se, deri në masën 300 lekë për një vakt? Nga znj B.T.	03.04.2024	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me kërkesën tuaj për informacion nëse pranë gjykatës ka patur lokal/apo vend të posaçëm për ngrenien për punonjësit, ju bëjme me dije se: Për periudhën 09.02.2018 deri më datë 28.02.2021, pranë institucionit ka ushtruar veprimtarinë nje ambient ne katin - I bar kafe ku punonjesit mund të konsumonin vaktin ushqimor. VKM-ja nr. 68, date 07.02.2018 “Për kufijte dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, nuk ka gjetur pasi punonjësve i është krijuar mundësia për konsumimin e vaktit ushqimor.	E plotë	Nuk ka
-----	------------	---	------------	--	---------	--------

12.	12.04.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit ndaj shtetases D.K nga z. A.L	22.04.2024	Kthim përgjigje ku nga verifikimi i sistemit (ICMIS), nuk rezulton asnjë vendim gjyqësor ndaj shtetases D.K	E plotë	Nuk ka
13.	07.05.2024	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të vendimeve mbi kërkesat për gjykim për rastet e vjedhjeve këmbana e Kishës së Shën Pjetrit vjedhur nga Kisha e Shën Pjetrit, Vithkuq Korçë, ndodhur në vitin 2017. Vjedhje nga Kisha e Shën Mërisë, Voskopojë, Korçë, ndodhur në vitin 2010 - 6 objekte kulti (shandanë). Ikonostasi i kishës, vjedhur nga Kisha Shën Thanasit, Voskopojë, Korçë, ndodhur në vitin 2011 nga znj. E.A “Amfora.al”.	13.05.2024	Çështjet penale të cilat gjykohen në gjykatë regjistrohen dhe si pasoje identifikohen përmes të dhënave (emër-mbiemër) të të pandehurit dhe dispozites konkrete të kodit penal të cilës i përket vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Si rrjedhojë në mungesë të këtyre të dhënave, nuk mund të kryhet kontrolli dhe identifikimi në regjistrat e gjykatës si dhe ne sistetmin (ICMIS) për t’ju vënë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe kopje të vendimeve gjyqësore përkatëse.	E plotë	Nuk ka

14.	13.05.2024	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni mbi kërkesat për vlerësimin e masave të sigurisë, vendimeve për masat e sigurisë, vendimeve për pushim të hetimeve, kërkesave për gjykim për të dyshuarit e Operacioneve Policore “Tempulli” nga znj.L.Ç “OCCRP”	22.05.2024	Vënë në dispozicion vendimet e anonimizuara.	E plotë	Nuk ka
15.	25.06.2024	Kërkesë për informacion për plotësimin e pyetësorit të Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC) lidhur me trafikimin e qënieve njerëzore neni 110/a të kodit penal për periudhën 2018-2023	08.07.2024	Në kuadër të plotësimit të pyetësorit të Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC) lidhur me trafikimin e qënieve njerëzore, ju bëjmë me dije se:Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për periudhën 2018-2023 nga verifikimi i kryer, nuk rezulton të ketë çështje penale për sa i përket veprës penale “Trafikimi i qënieve njerëzore” neni 110/a të kodit penal.	E plotë	Nuk ka

16.	23.07.2024	Kërkesë për informacion ndaj shtetasve S.H, dhe G.H nëse ka çështje gjyqësore penale dhe civile gjatë viteve 2015- 2024 dhe vënie në dispozicion të vendimeve nga gazetari S.K “Tv Klan”.	29.07.2024	Nga verifikimi i sistemit (ICMIS), rezultojnë dy çështje gjyqësore për periudhën 2015-2024 në të cilën keta shtetas janë në cilësinë e palës ndërgjyqëse. Çështja civile me me objekt: “Lëshimi i urdhërit të mbrojtës” me paditëse shtetasen S.H dhe të paditur shtetasin G.H. Gjykimi i kësaj çështje ka përfunduar. Çështja penale me objekt “Pushimi i çështjes penale” ku shtetasi G.H është në cilësinë e viktimës të veprës penale.Kjo çështje është ende në gjykim. Vënë në dispozicion vendimi i anonimizuar.	E plotë	Nuk ka
17.	02.09.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me çështjen gjyqësore për zgjidhje të martesës së shtetas M.T dhe B.T, se në cilën fazë gjyqësore ndodhet. Gjithashtu dhe shkaqet e përcaktuara në padi	04.09.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ju bëj me dije se: Nga verifikimi i kryer nuk rezulton e regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë çështje gjyqësore me objekt: “zgjidhje	E plotë	Nuk ka

		për zgjidhje të martesës dhe nga kush është deponuar padia. Nga gazetari A.B “Shqiptaria.com”.		martese”, midis shtetasve M.T dhe B.T.		
18.	02.09.2024	Kërkesë për informacion nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra” mbi vednimet gjyqësore për çështjet me objekt "Trafikimin e personave të rritur" parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, Trafikimin e të Miturve", parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, dhe veprën penale "Shfrytëzimi i prostitucionit parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal, për periudhën 2021-2023. 1)Sa është numri i procedimeve të regjistruara në gjykatën tuaj për çështjet me këtë objekt, të ndarë sipas objektit dhe sipas viteve; 2)Vënien në dispozicion të kopjeve të vendimeve	09.09.2024	Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për periudhën 2021-2023 nga verifikimi i kryer, nuk rezulton të ketë çështje penale për sa i përket veprave penale me objekt “Trafikimin e personave të rritur” neni 110/a të kodit penal, “Trafikimin e të miturve”, parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal dhe “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal.	E plotë	Nuk ka

		gjqësore të formës së prerë në lidhje me veprat penale të parashikuara në Seksionin VII të Kodit Penal. "Vepra Penale kundër Lirisë së Personit", Seksionin VIII "Vepra Penale kundër Moralit dhe Dinjitetit" dhe Seksionin IX "Vepra Penale kundër Fëmijëve, Martesës dhe Familjes", parashikuar në nenet 110/a, 114 dhe 128/b të Kodit Penal, për periudhën 2021-2023, të ndara sipas viteve, 3) Në sa prej rasteve është vendosur pranimi i fajësisë.				
19.	02.09.2024	Kërkesë për informacion vënien në dispozicion të kopjeve të vendimeve gjyqësore, për çështjet në të cilat kanë qenë të përfshirë shtetas të huaj, në veçanti shtetasit gjerman dhe që lidhen me kryerjen e veprës penale të parashikuar	10.09.2024	Nga verifikimi rezulton se ka përfunduar gjykimi i çështjes gjyqësore me kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me objekt Vleftësim si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit	E plotë	Nuk ka

		nga neni 291 "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt i Kodit Penal.Nga shtetasi A.D.		'Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik, parashkuar nga neni 239 i K.Pr. Penale, ndaj shtetasit nën hetim B.H.T. Vënë në dispozicion vendimi i anonimizuar.		
20.	04.09.2024	Kërkesë për informacion sa raste të martesave të shtetasve të mitur, nën moshën 18 vjeç, janë lejuar nga gjykata juaj në zbatim të nenit 7 të Kodit të Familjes gjatë periudhës 2017-2023? Sa prej këtyre rasteve përfshijnë shtetas të mitur meshkuj dhe sa prej tyre përfshijnë shtetas të mitur femra? Vënien në dispozicion të kopjeve të vendimeve. Nga gazetari S.C “BI Media”.	13.09.2024	Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për periudhen 2017-2023 gjykata me vendimet e saj, ka pranuar dy kërkesa duke lejuar lidhjen e martesës sipas nenit 7 të Kodit të Familjes. Në të dyja rastet kërkuese kanë qënë dy shtetase (femër) nën moshën 18 vjeç. Vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve të anonimizuara.	E plotë	Nuk ka
21.	06.09.2024	Kërkesë për informacion: 1.A kanë Gjykatat e të gjitha niveleve një zë në buxhet për të paguar	18.09.2024	1. Po Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka një zë të veçantë për pagimin e	E plotë	Nuk ka

		përkthyesit e gjuhës së huaj dhe interpretët e gjuhës së shenjave dhe sa ka qenë ky zë për secilin nga 5 vitet e fundit? 2. Sa është buxheti i përdorur për përkthyesit zyrtarë të gjuhëve të huaja, në procesin penal, në 5 vitet e fundit, nga gjykatat e të gjitha niveleve për secilin vit? 3. Sa është buxheti i përdorur për përkthyesit zyrtarë të gjuhës së shenjave, në procesin penal, në 5 vitet e fundit, nga gjykatat e të gjitha niveleve për secilin vit? 4. Sa procese penale me të pandehur persona me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe të folur ka pasur në gjykatat e të gjitha niveleve në 5 vitet e fundit, për secilin vit? 5. Me çfarë procedure dhe nga kush realizohet përzgjedhja dhe kontaktimi i përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe të gjuhës së shenjave për një proces penal? 6. Si llogaritet pagesa që përfiton një përkthyes zyrtarë i gjuhës së huaj	përkthyesve të gjuhëve të huaja dhe interpretët e gjuhëve të shenjave. -Për vitin 2019 ka qenë në vlerën 15.275 leke, -Për vitin 2020 në vlerën 6000 lekë -Për vitin 2021 në vlerën 42.000 lekë, -Për vitin 2022 nuk ka patur asnjë rast, -Për vitin 2023 në vlerën 11.174 lekë, 2. Buxheti i përdorur për përkthyesit në pesë vitet e fundit është në vlerën 74 449 lekë. 3. Buxheti i përdorur për përkthyesit në pesë vitet e fundit është në vlerën 74 449 lekë, i ndarë në vite si më poshtë: Viti 2019 ka qenë në vlerën 15.275 leke, Për vitin 2020 në vlerën 6000 lekë Për vitin 2021 në vlerën 42.000lekë, Ti dërgove Për vitin 2022 nuk ka patur asnjë rast Për vitin 2023 në vlerën 11.174 lekë, ky zë në buxhet është i ndryshueshëm në varësi të rasteve për kryerjen e pagesave të përkthyesve apo interpretëve të gjuhës së shenjave. 4. Gjatë këtij pesë vjeçari nuk ka patur asnjë proces penal me të pandehur		
--	--	--	---	--	--

		dhe i gjuhës së shenjave për procesin penal dhe me çfarë procedure e afatesh kohore realizohet kjo pagesë? 7. Si ka funksionuar përkthimi në procesin penal i personave që nuk dëgjojnë përpara çertifikimit të interpretëve të gjuhës së shenjave nga Ministria e Drejtësisë? 8. A janë gjykatat e të gjitha niveleve përgjegjëse për të paguar përkthyesit e gjuhëve të huaja dhe interpretët zyrtarë të gjuhës së shenjave për shërbimet që ata kryejnë në strukturat e policisë dhe prokurorisë për shtetasit e huaj dhe personat që nuk dëgjojnë? 9. Sa refuzime ka pasur këto 5 vitet e fundit nga përkthyesit zyrtarë të çertifikuar nga Ministria e Drejtësisë për të marrë pjesë në një proces penal dhe cilat kanë qenë arsyet e këtyre refuzimeve? 10. Sa raste të mospagesës së përkthyesve të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave nga gjykatat e të gjitha		persona me aftësi të kufizuara në dëgjim apo në të folur. 5. Përzgjedhja e listës së përkthyesve apo interpretevë të gjuhës së shenjave bëhet nga gjyqtari relator duke ju referuar listës së ekspertëve të miratuar nga Ministria e Drejtësisë. 6. Më pare pagesa llogaritej në bazë të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Financave nr. 3165, datë 12.05.2004, dhe me hyrjen në fuqi të udhëzimit nr. 8, datë 19.07.2022 "Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike". 7. Në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk ka patur asnjë çeshtje gjyqësore për përkthimin në procesin penal të personave që nuk dëgjojnë. 8. Jo gjykatat nuk kanë lidhje me	
--	--	--	--	---	--

		niveleve ka pasur në këto 5 vitet e fundit, për secilin vit dhe pse? Nga shtetësia J.C.		procedurat që kryejnë strukturat e policisë apo prokurorisë në rastet e thirrjes së përkthyesve apo interpretëve të gjuhës së shenjave. Ato kanë buxhet të pavarur nga gjykata. 9. Nuk ka patur asnjë rast refuzimi. 10. Nuk ka patur asnjë rast mospagesë të përkthyesve zyrtarë nga ana jonë.		
22.	24.09.2024	Kërkesë për informacion për plotësimin e pyetësorit mbi aksesin në drejtësi për personat me aftësi të kufizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK).	01.10.2024	Dërguar pyetësori i plotësuar mbi aksesin në drejtësi për personat me aftësi të kufizuar.	E plotë	Nuk ka
23.	24.09.2024	Kërkesë për informacion: 1. Sa martesë nën 18 vjeç kanë lejuar gjykatat e vendit në vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024 (periudha janar-gusht)? (të dhënat e ndara sipas viteve); 2. Cilat qytete kanë numrin më të lartë të martesave të hershme nën 18 vjeç të konfirmuara nga gjykatat në vitin	01.10.2024	Nga verifikimi i sistemit ICMIS rezulton se për vitet 2021 dhe 2023 nuk ka patur asnjë kërkesë të regjistruar për gjykim me objekt lejim lidhje martese. Në vitin 2022 ka përfunduar gjykimi i një çështje me objekt lejim lidhje martese e cila në thelbin e vet ka pëlqimin e lire të personave që lidhen në martesë dhe në këtë	E plotë	Nuk ka

		2023? (shifrat e ndara sipas qyteteve); 3. Cilave komunitete i përkasin këto martesë të konfirmuara në vitin 2023? 4. Cilat janë shkaqet kryesore që gjykatat në vend kanë lejuar martesat nën 18 vjeç në vitin 2023. Nga gazetaria D.H “TV Klan”.		rast shkak i lidhjes së martesës është shtatëzania në moshë të hershme e kërkuarës. Për vitin 2024 është regjistruar për gjykim një çështje me objekt lejim lidhje martesë kërkuarësja i përket komunitetit rom.		
24.	26.09.2024	Kërkesë për informacion: Sa është numri i çështjeve të regjistruara pranë Gjykatës suaj, që presim për t'u gjykuar deri më tani. Nga shtetësia Xh.A	03.10.2024	Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, numri i çështjeve të regjistruara, që nuk kanë përfunduar së gjykuari janë 2214 çështje.	E plotë	Nuk ka
25.	27.09.2024	Kërkesë për informacion: 1. Statistika për numrin e çështjeve civile me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar - 1 Shtator 2024, të ndara sipas neneve 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta", 625 "Përgjegjësia për dëmin jopasuror", 647/a të Kodit Civil. 2. Statistika për numrin e	04.10.2024	Nga verifikimi i sistemit ICMIS per periudhën Janar- Shtator 2024, nuk rezultojnë e depozituar për gjykim asnjë çështje gjyqësore me palë gazetarë apo punonjës të medias. Përgjatë vitit 2024, janë regjistruar për gjykim 3288 çështje të reja dhe janë mbartur 2166 çështje. Sqarojmë se, pranë gjykatës nuk ka një	E plotë	Nuk ka

		çështjeve penale me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar-1 Shtator 2024, të ndara sipas neneve 119 "Fyerja", 120 "Shpifja", 121 "Ndërhyrje të padrejta në jetën private", 143/b "Mashtrimi kompjuterik", 186/a "Falsifikim kompjuterik", të Kodit Penal. Ti dërgove 3. Vendimmarrja përkatëse për këto çështje: vendime dënimi, pafajësie, pushimi, pranim apo rrëzim padie. 4. Informacion mbi numrin e çështjeve të reja për vitin 2024 dhe informacion për sa çështje janë të mbartura. 5. Informacion mbi faktin nëse disponohet një regjistër të dhënash mbi gazetarët dhe punonjësit e mediave ku regjistrohen rastet e padive/çështjeve ndaj tyre. Nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCIDEV).		database ku të jenë të pasqyruara të dhënat mbi gazetarët apo punonjësit e medias, por administrohet një regjistër ku regjistrohen kërkesëpaditë dhe kërkesat e ndryshme që vinë në gjykatë.		
--	--	---	--	---	--	--

26.	01.10.2024	Kërkesë për informacion vënie në dispozicion të vendimeve civile-penale për periudhën 2009 – 2024 ndaj shtetasit D.M nga gazetari S.K “TV Klan”.	10.10.2024	Nga verifikimet e kryera rezulton vetëm një vendim i dhëne nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ndaj shtetasit D.M, për periudhën 2009-2024. Vënë ne dispozicion vendimi i anonimizuar.	E plotë	Nuk ka
27.	01.10.2024	Kërkesë për informacion vënie në dispozicion të vendimeve civile-penale për periudhën 1997 – 2004 ndaj shtetasit K.G dhe për periudhën 2005 – 2024 ndaj të njëjtit shtetasit L.G nga gazetari S.K “TV Klan”.	10.10.2024	Nga verifikimet e kryera nuk rezulton asnjë vendim i dhëne nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ndaj shtetasit K.G, për periudhën 1997-2004. Për periudhën 2005-2024 rezulton vetëm një vendim i dhëne nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ndaj shtetasit L.G. Vënë ne dispozicion vendimi i anonimizuar.	E plotë	Nuk ka
28.	01.10.2024	Kërkesë për për informacion vënie në dispozicion të vendimeve civile-penale	10.10.2024	Nga verifikimet e kryera rezulton vetëm një vendim i dhëne nga Gjykata e Shkallës së	E plotë	Nuk ka

		për periudhën 2008 – 2024 ndaj shtetasit V.Sh nga gazetari S.K “TV Klan”.		Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ndaj shtetasit V.SH, për periudhën 2008-2024. Vënë ne dispozicion vendimi i anonimizuar.		
29.	01.10.2024	Kërkesë për për informacion vënie në dispozicion të vendimeve civile-penale për periudhën 2010 – 2024 ndaj shtetasit V.G nga gazetari S.K “TV Klan”.	10.10.2024	Nga verifikimet e kryera rezultojnë shtatë vendime të dhëne nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ndaj shtetasit V.G, për periudhën 2010-2024. Vënë ne dispozicion vendimet e anonimizuara.	E plotë	Nuk ka
30.	01.10.2024	Kërkesë për për informacion vënie në dispozicion të vendimeve civile-penale për periudhën 2008 – 2024 ndaj shtetasit E.P nga gazetari S.K “TV Klan”.	10.10.2024	Nga verifikimet e kryera nuk rezulton asnje vendim gjyqësor ndaj shtetasit E.P për periudhën 2008 – 2024.	E plotë	Nuk ka
31.	01.10.2024	Kërkesë për për informacion vënie në dispozicion të vendimeve civile-penale për periudhën 2009 –	10.10.2024	Nga verifikimet e kryera rezulton vetëm një vendim i dhëne nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të	E plotë	Nuk ka

		2024 ndaj shtetasit A.M nga gazetari S.K “TV Klan”.		Përgjithshëm Korçë ndaj shtetasit A.M, për periudhën 2009-2024. Vënë ne dispozicion vendimi i anonimizuar.		
32.	07.11.2024	Kërkesë për për informacion vënie në dispozicion të vendimit ndaj shtetasit I.Z, gjithashtu dhënie aksesi në dosjen e plotë gjyqësore në ngarkim të këtij shtetasi nga gazetari S.K “TV Klan”.	14.11.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, bashkëngjitur po ju vendos në dispozicion vendimin e kërkuar të anonimizuar ndaj shtetasit I.Z. Për sa i takon aksesit në dosjen e plotë gjyqësore në ngarkim të shtetasit I.Z ju informoj se, çështja ka qënë me objekt “Dërgimi i çështjes në gjyq”, dhe në këto kushte gjykimet në seancë paraprake, sikurse masat e sigurimit, dërgimi në gjyq seancat zhvillohen me dyer të mbyllura dhe në këtë kuptim këto akte të dosjes nuk mund t`u jepen palëve të treta.	E plotë	Nuk ka
33.	15.11.2024	Kërkesë për informacion nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) është Organizatë	18.11.2024	Pasi u njohëm me kërkesën tuaj për informacion, po ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar	E plotë	Nuk ka

		Jofitimprurëse, pjesë e të cilës janë 10 organizata të cilat ushtrojnë veprimtarinë kryesisht në mbrojtje të grave viktima të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Në kuadër të fushatës “16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore” kërkojmë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, informacion lidhur me statistikat, për Urdhërave të Mbrojtjes, për periudhën Janar-nëntor 2024 (pranuar/ rrëzuar). Nëse nuk keni statistika të përfunduara për periudhën e mësipërme, të na vendoset në dispozicion çdo informacion që dispononi për Urdhërat e Mbrojtjes për këtë periudhë nga znj. R.A.		mbi statistikat për Urdhërat e Mbrojtjes për periudhën janar-shtator 2024. Këto statistika të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë mund ti aksesoni edhe në linkun https://gjykata.gov.al/rrethi-korce%C3%AB/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-korce%C3%AB/ në rubrikën statistika. Për sa i takon statistikave të kërkuara nga ana juaj mbi Urdhërat e Mbrojtjes deri në nëntor 2024 ju bëj me dije se, nuk i disponojmë ato. Përpunimi dhe nxjera e statistikave zyrtare të gjykatës, kryhet në përfundim të çdo tre mujori të vitit kalendarik.		
--	--	--	--	---	--	--

34.	12.12.2024	Kërkesë për informacion nga Redaksia e Medias Amfora.al, në lidhje me veprat penale si më poshtë: Sa vendime ka dhënë organi juaj në 10 vitet e fundit? Na vini në dispozicion vendimet e dhëna për këto vepra penale për secilin rast. Neni 138 Vjedhja e veprave të artit e kulturës, Neni 147 Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës, Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës	18.12.2024	Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë në 10 vitet e fundit për periudhën 2015-2024 nga verifikimet e kryera, nuk rezulton asnjë vendim i dhënë për sa i përket veprave penale me objekt “Vjedhja e veprave të artit e kulturës” parashikua nga neni 138 i Kodit Penal, “Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës”, parashikuar nga neni 147 i Kodit Penal dhe “Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës” parashikuar nga neni 138/a i Kodit Penal.	E plotë	Nuk ka
35.	17.12.2024	Kërkesë për informacion mbi numrin e çështjeve që kanë qenë të rregjistruara pranë Gjykatës suaj përpara miratimit të hartës së re gjyqësore dhe pas datës së implementimit të hartës, pra pas bashkimit të gjykatave për të studiuar me detaje ngarkesën që erdhi si pasojë e hartës së re	20.12.2024	Sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 134, datë 28.03.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, para implementimit të hartës gjyqësore në organikën e gjykatës ushtronin funksionin 7 gjyqtarë dhe në këtë	E plotë	Nuk ka

		gjqësore, duke përfshirë këtu dhe organikën e gjyqtarëve dhe numrin e gjyqtarëve që kanë qenë duke shërbyer para miratimit të hartës dhe sa shërbejnë aktualisht. Nga znj. M.J		periudhë kishin për gjykim 1585 çështje gjyqësore civile dhe penale. Pas implementimit të hartës gjyqësore ushtronin funksionin 11 gjyqtarë, në fund të gjashtë muorit të parë kishin për gjykim 2325 çështje gjyqësore. Gjykata raporton statistikat gjyqësore sipas periudhave tre mujore, pas implementimit të hartës gjyqësore vihet re një numër çështjes gjyqësore në rritje, për shkak të bashkimit të Gjykatas së Rrethit Gjyqësor Pogradec në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë për efekt të implementimit të hartës gjyqësore.		
36.	20.12.2024	Kërkesë për informacion lidhur me çështjen që i përket shtetases J. K, me objekt: zgjidhje martese, duam të dime se kur u mbajt seanca e fundit dhe çfarë u vendos në përfundim? Ka një pretendim nga ana e	23.12.2024	Lidhur me çështjen civile me palë paditëse: J. K, i paditur: K. K, me objekt: “Zgjidhja e martesës dhe rregullimi i pasojave të saj”, seanca e fundit është zhvilluar në datën 18.12.2024 ora 09:30 në Gjykatën e Shkallës së	E plotë	Nuk ka

		kësaj shtetaseje, konkretisht nga bashkejetuesi i saj se, nuk kishin dijeni se seanca e radhës do të zhvillohej në dt.18.12.2024. Sipas tyre, ata ishin të bindur se data e njoftuar ne gjykatë ishte 19.12.2024 dhe jo 18.12.2024 dhe kjo ka bërë që gjykimi të pushohet. Na tregoni zyrtarisht se seanca ishte njoftuar për në dt 18 dhe si u be njoftimi për palet.Nga gazetari z. A.P		Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në të cilën është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes. Paditësja ka patur dijeni për datën dhe orën e caktuar të kësaj seance për shkak të pjesëmarrjes së saj në seancën e mëparshme date 29.10.2024, ndërkohë, edhe i padituri ka marrë dijeni për të, nëpërmjet njoftimit me letërthirrje në adresën e vendosur nga paditësja në kërkesëpadi, duke u nënshkruar akti përkatës nga babai i tij (person i familjes mbi 16 vjeç, i njohur nga ligji për marrjen e njoftimit sipas nenit 131 të K. Pr. Civile). Në kushtet, ku ka rezultuar se, paditësja ka patur dijeni të rregullt për datën e orën e gjykimit të seancës pajtimore dhe nuk i ka bërë prezent gjykatës ndonjë shkak të arsyeshëm për mospjesëmarrjen, si dhe		
--	--	--	--	--	--	--

				meqënëse seanca pajtimore zhvillohet vetëm me praninë personalisht të bashkëshortëve sipas nenit 134 të Kodit të Familjes (jo përfaqësuesve të tyre ligjore), bazuar në nenin 135 të Kodit të Familjes e nenin 299 të K. Pr. Civile, gjykata ka qënë e detyruar të vendosë pushimin e gjykimit.		
37.	26.12.2024	Kërkesë për informacion lidhur me çështjen ndaj shtetasit E.R. Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj: Çfarë vendosi gjykata?A u pranua kërkesa e prokurorisë për pushim çështje? . Nga gazetaria znj. L.K	30.12.2024	Në lidhje me kërkesën penale ndaj shtetasit E.R me objekt: “Pushimi i çështjes penale” kjo çështje është ende në gjykim. Gjithashtu ju sqaronjmë se gjykimet për kërkesat për pushim/dërgim në gjyq zhvillohen me dyer të mbyllura.	E plotë	Nuk ka